



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0484

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vjosa Gradinaj Mexhuani Kryetare, Vedat Poterqoi-Referues dhe Agon Ramadani-Anëtar duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik “Runway” S.H.P.K. me Nr. 484/23 të datës 12.07.2023 si dhe ankesën e operatorit ekonomik “Solid” S.H.P.K. me Nr. 486/23 të datës 13.07.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 23.06.2023 të Autoritetit Kontraktues - Ministria e Mbrojtjes lidhur meaktivitetin e prokurimit me titull “Ritender - Furnizim me çizme ushtarake për nevojat e FKS-së” me numër të prokurimit 217-22-7705-1-1-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas mbajtjes së seancës publike për shqyrtimin kryesor me datë 30.08.2023 me prezencën e palëve dhe ekspertit shqyrtues, me datë **15.09.2023** merr këtë:

Vendim

1. Aprovohen pjesërisht të bazuara, ankesa e OE “Runway” SH.P.K. me Nr. Protokolli 484/23 e datës 12.07.2023 dhe ankesa e OE “Solid” SH.P.K. me Nr. Protokolli 486/23 e datës 13.07.2023 dhe AnulohetVendimi i AK i datës 23.06.2023 për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri-tender - Furnizim me çizme ushtarake për nevojat e FKS-së” me numër të prokurimit 217-22-7705-1-1-1, kurse lënda kthehet në **Rivlerësim**.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Në të kundërtën , për mos respektim të vendimit OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa ndaj AK, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i konsoliduar).
3. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emrin e tarifës ankimore, kurse ankuesit kanë të drejtë që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) pas ditës së pranimit të këtij vendimi të parashtrajnë kërkesë për kthimin e mjeteve në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP.
4. Paneli shqyrtues në kuadër të OSHP do të Inicioj procedura në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) për ndërmarrjen e masave ndaj zyrtarit përgjegjës të prokurimit për zbatimin e kësaj procedure tenderuese në kundërshtim më dispozitat ligjore të nenit 1, 7, 59, 60 dhe nenit 25, paragrafi 9 i LPP-së.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Ministria e Mbrojtjes në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 01.08.2022 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ritender- Furnizim me Çizme ushtarake për nevoja të FSK-së” i evidentuar me numër prokurimi 217-22-7705-1-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 2,000,000.00 €.

Me datë 28.10.2022, Autoriteti Kontraktues ka bërë hapjen e ofertave ndërsa me datë 27.01.2023 ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin për dhënien e kontratës Grupit të Operatorëve Ekonomik “Furkan Rada & Ozkan Kundura ve lastik Imalat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi”.

Me datë 01.02.2023 operatori ekonomik “Runway” Sh.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 27.01.2023 ndërsa me datë 03.02.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit e ka refuzuar si të pabazuar këtë kërkesë. Tutje me datë 01.02.2023 edhe operatori ekonomik “Solid” Sh.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 27.01.2023 ndërsa me datë 03.02.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën.

Me datë 13.02.2023 operatori ekonomik “Runway” Sh.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 80/23 kundër vendimit të cituar më sipër të Autoritetit Kontraktues. Njëkohësisht me datë 13.02.2023 operatori ekonomik “Solid” Sh.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 84/23 po ashtu kundër vendimit të cituar më sipër të Autoritetit Kontraktues.

Me datë 02.05.2023 OSHP ka publikuar vendimin me nr. 80-84/23 përmes të cilit ka hedhur si të palejuar ankesën e operatorit ekonomik “Runway” Sh.P.K. ndërsa e ka miratuar si të bazuar ankesën e operatorit ekonomik “Solid” Sh.P.K. ashtu që ka urdhëruar anulimin e vendimit të datës 27.01.2023 për dhënie të kontratës ndërsa aktivitetin e prokurimit e ka kthyer në rivlerësim.

Me datë 13.06.2023 pas procedurës së rivlerësimit, Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë sërish Grupin e Operatorëve Ekonomik “Furkan Rada & Ozkan Kundura ve lastik Imalat Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi”.

Me datë 27.06.2023 operatori ekonomik “Runway” Sh.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 13.06.2023. Me datë 04.07.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim. Tutje me datë 28.06.2023 edhe operatori ekonomik “Solid” Sh.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 13.06.2023. Me datë 04.07.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me datë 12.07.2023 operatori ekonomik ankues “Runway” Sh.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 484/23 ndërsa me datë 13.07.2023 operatori ekonomik ankues “Solid” Sh.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 486/23.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesave, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 484/23 dhe ankesa nr. 486/23 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Runway” Sh.P.K. janë parashtruar si në vijim:

- Pretendimi i parë (I): “Në specifikimin teknik të Ankesit nr. 1 për çizme verore është kërkuar që çizmja të ketë -Sistem i shpejtë i lidhsëve për mbathje dhe lëvizje-. Çizmet e operatorit ekonomik të rekomanduar nuk posedojnë këtë sistem të lidhsëve, të njëtat kanë sistemin me vrima për lidhëse dhe jo sistem të shpejtë për mbathje dhe lëvizje sipas nevojave”.
- Pretendimi i dytë (II): “Mostrat e ofruara nga ana e operatorit ekonomik, çizmet e mostrës nuk përmbajnë tiketat e prodhimit sipas autorizimit të paraqitur në ofertë, të njëtat po ashtu nuk përmbajnë as shënimet për standardin e kërkuar në specifikimin teknin EN ISO 20344:2021 dhe si e tillë është në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit dhe specifikimin teknik.
- Pretendimi i tretë (III): Operatori ekonomik i rekomanduar nuk ka dëshmuar se plotëson kërkesën e specifikimit teknik të detyrueshëm pasi që mostra e paraqitur nuk ka dëshmi dhe shënim se është e standardit EN ISO 20347:2021 dhe si e tillë është në kundërshtim me specifikimin teknik dhe katalogun e prezantuar si dhe shënimet e atesteve. Po ashtu operatori ekonomik nuk ka ofruar dëshmi sipas kërkesës që kemi kërkuar në Aneksin 1 te pika 7.1 dhe te pika 3.1 për deklaratën e përmbushjes së specifikimit teknik, siç e kemi cekur edhe në pretendimet ankimore të paraqitura më herët se Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar si duhet LPP Nenin 59 pasi që i njëjti ka kërkuar sqarime lidhur me mos plotësimin e kësaj pike - deklaratën e specifikimeve teknike. Gjithashtu AK ka vepruar edhe në kundërshtim me interpretimin e KRPP ku ka cekur se nëse është kërkuar deklarata e specifikimeve teknike dhe nuk e ka sjellë OE duhet të eliminohet”.
- Pretendimi i katërt (IV): “Operatori ekonomik i rekomanduar fare nuk ka dorëzuar atestet andaj komisioni i vlerësimit ka bërë shkelje të Nenit 59 dhe kriterëve të kërkuara në dosjen e tenderit si dhe vendimit të OSHP duke rekomanduar operatorin ekonomik të pa përgjegjshëm”.
- Pretendimi i pestë (V): “Operatori ekonomik Solid SHPK ka prezantuar Atestet për këpuca në kundërshtim me kërkesën e kërkuar nga ju si AK si dhe sqarimet e japura nga ana juaj me datën 28.09.2023, këto raporte të atesteve janë bërë në Laboratorin MAK-KONTROLL në Maqedoninë e

Veriut. Duke pasur parasysh kërkesën tuaj që laboratorin duhet që të jetë i akredituar për secilin produkt të kërkuar në specifikim teknik si dhe të ketë vlerat në raport të atesteve operatori ekonomik ka prezantuar raportet e atesteve pa këto vlera të kërkuara sipas standardeve si më lart, si dhe ka prezantuar laboratorin i cili nuk ka akreditim për EN ISO të kërkuara sipas produkteve të cekura si më sipër dhe si rezultat i kësaj i njëjti është dashur që sipas kriterëve të aneksit nr. 1 të DT dhe bazuar në nenin 59 të LPP që të eliminohet si i pa përgjegjshëm”.

- Pretendimi i gjashtë (VI): “Çizmet e ofruara nga ana e operatorit ekonomik (Solid SHPK) janë në kundërshtim me specifikimin teknik si dhe me ateste dhe katalog, pasi që Çizmet e prera verëhen shumë qartazi se përmbajnë vendosje të sasisë së konsiderueshme të hekurit dhe nuk ka elasticitet siç është kërkuar, nuk ndihmon kthimin në gjendje normale të çizmes dhe nuk mbështet ecje dhe vrapim të rehatshëm, e njëjta paraqet edhe rrezik që gjatë ushtrimeve praktike të grisen dhe të krijojnë kontakt me këmbën që do të dëmton tej mase si dhe kontakte të tjera të rrezikshme në natyrë siç mund të jenë energjia elektrike (etj), çizmjat nuk është e prodhuar nga goma por ka pjesë metalike. Po ashtu është kërkuar që shuallit të jetë i punuar me sistemin e injeksionit direkt, dhe jo të jetë e kapur me ngjites siç është prezantuar mostra”.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues “Runway” Sh.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 10, 28, 59, 60, 70 dhe 72 të LPP si dhe nenin 38 të RRPP. Operatori ekonomik ankues ka kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të miratohet ankesa ashtu që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Solid” Sh.P.K. janë parashtruar si në vijim:

- Pretendimi i parë (I): “Kërkesa e AK e specifikuar në FDT neni 8.1 & 8.2 - Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, GOE të rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar këtë pikë për arse se OE përfaqësues i grupit nga Turqia ka dorëzuar vërtetimet e qarkullimit bankar në kundërshtim me nenin 13 të LPP duke i ofruar ato në gjuhë jo zyrtare sipas këtij ligji ndërsa AK i ka pranuar si të mirëqena, shtu këtu faktin që AK nuk ka dhënë as një dëshmi se gjatë rivlerësimit ka angazhuar ndonjë përkthyes ligjor për të verifikuar apo sqaruar këto dokumente nëse i plotësojnë apo jo kërkesat e DT”.
- Pretendimi i dytë (II): “Kërkesa e AK e specifikuar në FDT - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale - Kërkesa nr. 09 - GOE të rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar këtë pikë, sepse ka ofruar vetëm një foto të produktit të paraqitur si Çizme vere dhe Çizme dimri. Pra vërehet shumë qartë që është në kundërshtim me kërkesën e AK, shtu këtu faktin që dokumenti i ofruar nga GOE të rekomanduar për kontratë nuk ngjason me katalog, por është një përshkrim bazuar në specifikat teknike të AK pa dhënë as një dëshmi tjetër si Ateteset. Po ashtu vendimi i OSHP me nr. 80-84/23 i datës 02.05.23 e ka kontestuar këtë pikë dhe e ka cilësuar në kundërshtim me nenin 59 të LPP”.
- Pretendimi i tretë (III): “Kërkesat e AK të specifikuara në pyetjet sqaruese të datës 28.09.2022 lidhur me Atestet e produkteve nga Laboratorët e Akredituar dhe sipas Standardeve ISO, nuk janë plotësuar fare nga GOE të rekomanduar për kontratë sepse të njëjtit nuk ka ofruar fare Ateste për produktet e ofruar e lëre më nga laboratorët e akredituar. Gjithashtu vërejmë se edhe në raportin e rivlerësimit AK nuk ka respektuar kërkesat lidhur me Atestet nga laboratorët e akredituar si dhe në asnjë pikë nuk ka cekuar se ka kërkuar sqarime shtesë dhe as dokumente plotësuese nga GOE i rekomanduar për kontratë për të sqaruar këtë kërkesë, po ka vepruar njëjtë sikur herën e parë. Po ashtu vendimi i OSHP me nr. 80-84/23 i datës 02.05.23 e ka kontestuar këtë pikë dhe e ka cilësuar si veprim jo në harmoni me dispozitat ligjore të LPP dhe ka kërkuar nga AK që gjatë rivlerësimit të ketë në konsideratë shpjegimet e dhëna, në të kundërtën OSHP e ka autoritetin e plotë dhe kompetencat që të inicioj

procedurën për ndërmarrjen e masave përkatëse”.

- Pretendimi i katërt (IV): “AK në specifikimet teknike për Çizmet verore, ka kërkuar që të jenë nga materialet ajrosëse dhe me përmbushje të specifikave GoreTex ose Ekuivalent. Përgjatë kontrollimit të mostrave të ofruara nga GOE të rekomanduar për kontratë është vërtetuar se OE ka ofruar materiale të thjeshta i cili aspak nuk ka të bëjë me kërkesën e AK sepse materiali është tekstil i thjeshtë me vrima. Në një pikë sqaruese për të cilën AK ka kërkuar nga GOE i rekomanduar për kontratë, GOE citon se materiali është Ekuivalent - GoTe Tex dhe AK e ka marrë si të mirëqenë këtë sqarim, pa bërë as një analizë apo testim. Ne si prodhues vendor ju garantojmë se materiali (Ekuivalent - GoTe Tex) nuk ekziston fare në lëminë e veshmbathjeve”.
- Pretendimi i pestë (V): “AK në specifikimin teknik ka kërkuar që çizmet të kenë sistem të shpejtë të lidhëseve për mbathje dhe lëvizje. GOE i rekomanduar për kontratë në mostrat e ofruara vërtetohet se nuk e posedon këtë sistemin të shpejtë të lidhëseve, që nënkupton se mostrat e ofruara nuk përmbushin kërkesën e AK, ku edhe në këtë rast GOE duhej të eliminohej nga konkurrenca e mëtejme. Po ashtu mënyrën e lidhëseve mund ta shihni shumë qartë që sistemi i tillë i lidhëseve nuk ka të bëjë aspak me sistem të shpejtë sipas kërkesës së AK”.
- Pretendimi i gjashtë (VI): “Në specifikimin teknik AK ka kërkuar që Gryka e çizmeve të jetë 5mm me densitet 70PU shkumë, ndërsa bazuar në kontrollin e mostrës së GOE të rekomanduar për kontratë mostra nuk posedon gryken prej 5mm me densitet 70PU shkumë, kjo mund të vërehet shumë lehtë dhe nëse matet”.
- Pretendimi i shtatë (VII): “AK në specifikimin teknik ka kërkuar që lidhëset e çizmeve të jenë POLIESTER ose POLIAMIDE. Përgjatë kontrollimit të mostrave të GOE të rekomanduar për kontratë, kemi vërtetuar që të njëjtit kanë ofruar lidhëse të thjeshta për çizmet e ofruara e cila është në kundërshtim me kërkesën e AK”.
- Pretendimi i tetë (VIII): “AK në specifikimin teknik ka kërkuar që trashësinë e lëkurës të jetë minimum 2.0mm, ndërsa gjatë kontrollit të mostrave të GOE të rekomanduar për kontratë, vërehet se trashësia e lëkurës nuk përkon me trashësinë me të madhe se 1.6-1.8mm (e matur me mjete klasike në prezencën e AK dhe me mjetet e ofruar nga AK)”.
- Pretendimi i nëntë (IX): “AK në specifikimin teknik ka kërkuar që Materiali për gjuhen e çizmes duhet të jetë konform standardit ISO me 3-4 shtresor, ndërsa gjatë kontrollit të mostrës së GOE të rekomanduar vërtetohet se produkti i ofruar është me Syngjer të thjeshtë”.
- Pretendimi i dhjetë (X): “AK në DT dhe specifikimin teknik ka kërkuar që gjoni i çizmeve të jetë rezidentë ndaj vajrave, naftës etj. Gjate kontrollit të mostrave të GOE i rekomanduar për kontratë si dhe specifikimit teknik të ofruar nuk përshkruan askund që gjoni i çizmeve të ofruar është sipas kërkesës së AK, po ashtu GOE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar asnjë certifikate si dëshmi apo atest nga laboratorët e certifikuar se produktet e ofruar e përmbushin këtë pikë. AK ka kërkuar që lëkura e çizmeve të jetë të qëndrueshme dhe të kenë rezistencë të lartë ndaj gërvishjeve. Gjatë kontrollit të mostrave të GOE i rekomanduar si dhe specifikimit teknik të ofruar nuk përshkruan që produktet e ofruara e plotësojnë këtë kriter. Gjate kontrollit të mostrës shihet se çizmet e prezantuara kanë fraktura në lëkurë ende pa u përdorur dhe gërvishten lehtë”.
- Pretendimi i njëmbëdhjetë (XI): “AK në DT dhe specifikimin teknik ka kërkuar që për çizmet dimërore shtrojat duhet të jenë të formësuar, ortopedike dhe që nuk djersiten dhe që të mund të zëvendësohen. Gjatë kontrollit të mostrave të ofruar nga GOE i rekomanduar për kontratë, shihet që shtroja e ofruara është e rrafshët, e hollë, krijonë djersë dhe rrëshqitje të këmbës, dhe nuk ka fare lidhje me format ortopedike dhe nuk i posedojnë aspak vetitë e kërkuara nga AK”.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues “SOLID” Sh.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 13, 27, 28, 59, 60, 64, 66, 67, 69 dhe 71 të LPP si dhe nenin 39.8 të RRPP. Operatori ekonomik ka kërkuar nga Paneli Shqyrtues që të miratohet ankesa ashtu që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Bazuar në nenin 111 par. 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 17.07.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve

sipas ankesës me nr. 484/23. Po ashtu me datë 17.07.2023 Paneli Shqyrtues ka autorizuar ekspertin shqyrtues edhe për shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 486/23.

Lidhur me ankesën nr. 484/23 me datë 30.07.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0484 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e mësipërme, ekspertët i propozojnë panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Specifikisht duhet të kërkohet nga AK që të merr në konsideratë shpjegimet e dhëna në Vendimin nr.80/23 dhe 84/23 të datës 02.05.2023. Për vlerësimin e drejtë dhe të paanshëm të ofertave të këtij aktiviteti të prokurimit, rekomandohet që AK të dërgoj mostrat e dorëzuara nga OE-të në një laborator të akredituar ndërkombëtarisht, për të verifikuar që ato përbushin kërkesat teknike të DT”.

Lidhur me ankesën nr. 486/23 me datë 18.07.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0486 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e mësipërme, ekspertët i propozojnë panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Specifikisht duhet të kërkohet nga AK që të merr në konsideratë shpjegimet e dhëna në Vendimin nr.80/23 dhe 84/23 të datës 02.05.2023. Për vlerësimin e drejtë dhe të paanshëm të ofertave të këtij aktiviteti të prokurimit, rekomandohet që AK të dërgoj mostrat e dorëzuara nga OE-të në një laborator të akredituar ndërkombëtarisht, për të verifikuar që ato përbushin kërkesat teknike të DT”.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues ka deklaruar se nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues ndërsa operatorët ekonomik ankues “Runway” Sh.P.K. dhe “Solid” Sh.P.K. kanë deklaruar se pajtohen me rekomandimet në raportin e ekspertit shqyrtues.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportet e ekspertëve, mendimet e palëve lidhur me raportet e ekspertëve, parashtresat dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit, deklaratimet e palëve gjatë seancës së shqyrtimit kryesor si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Me datë 30.08.2023 është mbajtur seanca e shqyrtimit kryesor lidhur me këtë lëndë ku prezent ishin përfaqësuesit e palëve ankuese dhe përfaqësuesi i autoritetit kontraktues.

Përfaqësuesi i palës ankuese “Runway” Sh.P.K. gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë pretendimeve ankimore të parashtruara me ankesë si dhe ka konfirmuar se pajtohet plotësisht me rekomandimet e ekspertëve shqyrtues/teknik duke pohuar me tej se “Mostrat e ofruara nga ana e operatorit ekonomik të rekomanduar, çizmet e mostrës nuk përmbajnë tiketat e prodhuesit sipas autorizimit të paraqitur në ofertë, të njëjtat po ashtu nuk përmbajnë as shënimet për standardin e kërkuar në specifikimin teknik EN ISO 20344:2021 dhe si e tillë është në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit dhe specifikimin teknik po ashtu i rekomanduar është i papërgjegjshëm edhe për faktin se nuk ka plotësuar “Deklaratën për specifikacione teknike” për këtë aktivitet. Kurse sa i përket ofertuesit “SOLID” Duke pasur parasysh kërkesën tuaj që laboratorin duhet që të jetë i akredituar për secilin produkt të kërkuar në

specifikim teknik si dhe të ketë vlerat në raport të atesteve operatori ekonomik ka prezantuar raportet e atesteve pa këto vlera të kërkuara sipas standardeve si më lart, si dhe ka prezantuar laboratorin i cili nuk ka akreditim për EN ISO të kërkuara sipas produkteve të cekura si më sipër dhe si rezultat i kësaj i njëjti është dashur që sipas kritereve të aneksit nr. 1 të DT dhe bazuar në nenin 59 të LPP që të eliminohet si i pa përgjegjshëm.

Përfaqësuesi i palës ankuese “Solid” Sh.P.K gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë pretendimeve ankimore të parashtruara me ankesë dhe po ashtu ka konfirmuar se pajtohet plotësisht me rekomandimet sipas raportit të ekspertit shqyrtues. Më tutje ka shtuar se “përfundimisht theksojmë se është për të ardhur keq se si Autoriteti Kontraktues në përgjigjen ndaj kërkesës sonë për rishqyrtim për mungesë të A-testeve përgjigjet citoj <<referuar pikës 2 ne si AK nuk posedojmë laborator të testimit të materialeve>>. Kjo do thotë se Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin në shabllon. Po ashtu duhet të ceket se të gjitha këto vërejtje janë të evidentuara dhe vërtetuara edhe në vendimin e OSHP të datës 02.05.2023 me nr. 80-84/23 mirëpo pavarësisht kësaj, Autoriteti Kontraktues nuk ka përfillur asnjë nga këto të gjetura duke vepruar në kundërshtim me vendimin e cituar por edhe në kundërshtim të plotë me LPP ka rishpallur sërish fitues OE “Furkan”. Ne citojmë një paragraf të vendimit 80-84/2023 për këtë procesverbal <<...prandaj produkti në rastin konkret determinon objektivisht këtë proces të prokurimit sepse i njëjti ka të bëjë me kriterin kryesor dhe domethënës duke nënkuptuar faktin se ky produkt prezanton kriterin bazë të prokurimit, peshën kryesore të DT-së, specifikat etj, të cilat nga shkresat e kësaj lënde sipas panelit nuk është vërtetuar se OE i rekomanduar i plotëson...>>. Kurse sa i përket pretendimeve të operatorit ekonomik Runway Sh.P.K kundër operatorit ekonomik Solid Sh.P.K., me bindje të plotë deklarojmë se nuk qëndrojnë këto pohime dhe mund të vërtetoni se këto janë vetëm rekomandime boshe pasi që asnjë nga pikat e ankesës nuk kanë bazë ligjore dhe argumentuese. Laboratori Mak-kontroll në Maqedoni është i licencuar ndërkombëtarisht dhe i plotëson të gjitha standardet e kërkuara. Ne kemi një bashkëpunim disa vjeçar me të njëjtin. Prandaj për detaje ju lusim të referohuni çertifikatës së A-testit në të cilën janë të specifikuara gjitha ISO standardet e kërkuara në këtë dosje të tenderit për testimin e kualitetit të çizmeve.. Përveç kësaj po ashtu ju rekomandoj që personalisht t’i vërtetoni pretendimet tona, kurse adresën dhe kontaktet e laboratorit i gjeni në certifikatën e kualitetit. Vlen të ceket se ankuesi Runway Sh.P.K. cili është ankuar në rastin konkret është ankuar edhe ndaj një tenderi tjetër, ku fitues ka qenë Solid Sh.P.K. dhe pikërisht ankesa bazë e tij kanë qenë se laboratori Mak-kontroll në Maqedoni nuk plotëson standardet ISO të kërkuara. Kurse në kërkesë për sqarim të Autoritetit Kontraktues - Shërbimi Korrektues i Kosovës janë dhënë gjitha sqarimet me dëshmi se Mak-kontroll me seli në Maqedoni i plotëson standardet e kërkuara. Ju lutem për detaje referojuni zyrtarit të prokurimit të SHKK”.

Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se qëndron pranë njoftimit mbi vendimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit. Më tutje ka shtuar se: “Pas pranimit si komision vlerësues, gjitha ofertat janë trajtuar barabartë dhe paanshëm. Ne kemi problem me vite të tëra për furnizim me çizme pikërisht për shkak të ankesave dhe vonesës në procedura. Ne kemi rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik të përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Specifikat e kërkuara për standarde në dosje të tenderit ne nuk kemi laborator vendor për të bërë testim, mirëpo mundemi që me shpenzime të kompanisë pas lidhjes së kontrate ti dërgojmë në laborator për t’u vërtetuar se a janë në pajtim me kërkesa”.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues ka pyetur përfaqësuesin e autoritetit kontraktues se mbi çfarë bazë keni vlerësuar se operatori ekonomik i rekomanduar ka ofruar produktet në pajtim me kërkesa/specifikacion teknik me standardet ndërkombëtare të kërkuara. Po ashtu ka theksuar që sipas njoftimit të Panelit Shqyrtues përmes postës elektronike (email) të datës 28.08.2023 është kërkuar nga përfaqësuesi i autoriteti

kontraktues që të sjellin në seancë të gjitha dëshmitë lidhur me A-testet nga laboratorit i akredituar i operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë. Përfaqësuesi i autoritetit kontraktues është përgjegjës si në vijim: “Ne gjatë vlerësimit jemi bazuar vetëm në tabelën e ofruar nga AK në dosje të tenderit, ku janë cekur rezultatet dhe metoda e testimit, ndërsa si dëshmi kemi marrë tabelën e ofruar nga OE. Prodhuesit e veshmbathjeve kanë deklaruar të prodhuesit lidhur me specifikat e produkteve të tyre mbi të cilat ne si komision jemi orientuar dhe ne nuk kemi ditur dhe as nuk kemi kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar ngase ne mundemi konform kërkesës tek specifikacioni teknik, nëse e shohim të nevojshme siç e cekëm më lart ti dërgojmë me shpenzime të OE të rekomanduar të njëjtat në testim për të vërtetuar të dhënat e ofruara nga prodhuesi pas nënshkrimit të kontratës”. Tutje lidhur me këtë pyetje është deklaruar edhe përfaqësuesi i palës ankimore Solid SH.P.K. i cili pohoj se “operatori ekonomik i rekomanduar fare nuk ka ofruar katalog por ka ofruar një skicë të punuar me specifikime teknike të dosjes së tenderit, siç u cek më herët operatori ekonomik nuk ka pas deklaruar për specifikime teknike por e njëjta është kërkuar në fazën e rivlerësimit që nënkupton se autoriteti kontraktues ka bërë plotësimin të dokumentacionit në një fazë kur është e ndaluar sipas LPP dhe RRPP. Po ashtu në mungesë të Atestit autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar testimin e produktit gjatë vlerësimit të cilën i’a lejon dhe do duhej sipas LPP”.

Paneli Shqyrtues ka bërë edhe administrimin e raporteve të ekspertit shqyrtues me qëllim të vlerësimit dhe çmuarjes së lirë të provave dhe deklaramëve të palëve, secilës veç e veç dhe të gjithave së bashku.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues **“Runway” SH.P.Keksperti shqyrtues** përmes raportit nr. 2023/0484 ka vlerësuar si në vijim:

- Lidhur me pretendimin e parë (I) - “OE ankues nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për të konfirmuar këtëpretendim. Pretendimi është i pabazuar”.
- Lidhur me pretendimin e dytë (II) - “AK në përgjigjen e tij ka konfirmuar që mostrat e ofruara nga të gjithë OE kanë përmabjtur tiketën dhe dokumentacioni përcjellës si informator i prodhuesit ku specifikohen të dhënat e çizmeve. Pretendimi është i pabazuar”.
- Lidhur me pretendimin e tretë (III) - “Lidhur me këtë pikë dhe lidhur me këtë operator ekonomik ka vendim edhe nga PSH.OSHP me nr.80- 84/23 të datës 02.06.2023 i cili ka shpallur si të pa përgjegjshëm oferten e tij duke theksuar: Sipas Panelit nuk është vërtetuar se operatori ekonomik i rekomanduar i plotëson këtë kriter. Rrjedhimisht, ky pretendim është i bazuar”.
- Lidhur me pretendimin e katërt (IV) - “Ky formulim është kuptuar nga OE-të ankues si një obligim i ri që të dorëzojnë bashkë me ofertat e tyre edhe Atestet nga laboratorë të akredituar ndërkombëtarisht dhe ato të përmbajnë rezultatet e testimit fizik të çizmeve që ofrohen me këtë tender. Pra, sqarimet që janë dhënë nga AK kanë krijuar obligime shtesë për palët e interesuara. Ato janë shndërruar në kritere shtesë, të cilat nuk kanë qenë fillimisht pjesë e dosjes së tenderit dhe rrjedhimisht është dashur të respektohen nga Komisioni i vlerësimit të tenderëve në mënyrë që të sigurohet trajtimi i barabartë i ofertuesve. Siç u theksua më sipër, një kërkesë e tillë është kërkuar nga AK edhe me Vendimin e OSHP-së të përmendur më lartë, por as Komisioni i rivlerësimit nuk e ka marrë parasysh këtë. Rrjedhimisht, ky pretendim është i bazuar”.
- Lidhur me pretendimin e pestë (V) - “Pretendimi ankimor është i pa bazuar pasi OE ankues nuk ka prezantuar atestet për të cilat supozon se janë në kundërshtim me specifikimin teknik”.
- Lidhur me pretendimin e gjashtë (VI) - “Nga mostrat e prezantuara mund të krijohet përshtypja se kanë devijime nga specifikimi teknik. Megjithatë, do të ishte e nevojshme të bëhen teste laboratorike shtesë për të konfirmuar plotësisht pretendimin e OE ankues. Ky pretendim mund të konsiderohet si pjesërisht i bazuar”.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Solid” SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0486 ka vlerësuar si në vijim:

- Lidhur me pretendimin e parë (I) - “Sipas nenit 13 paragrafit 4 të LPP është përcaktuar se një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze. Së këndejmi ky pretendim është i bazuar”.
- Lidhur me pretendimin e dytë (II) - “Siç është shqyrtuar edhe në Vendimin e OSHP-së të sipërpërmendur, arsyetimi i AK-së se “ngatërrimi i fotove duket qartë se është një gabim teknik” nuk është i qëndrueshëm. Rrjedhimisht, Paneli i OSHP- së ka konsideruar se AK nuk ka vepruar në harmoni me dispozitën e nenit 59 të LPP, prandaj ky pretendim është i bazuar”.
- Lidhur me pretendimin e tretë (III) - “Ky formulim është kuptuar nga OE-të ankues si një obligim i ri që të dorëzojnë bashkë me ofertat e tyre edhe Atestet nga laboratorë të akredituar ndërkombëtarisht dhe ato të përmbajnë rezultatet e testimit fizik të çizmeve që ofrohen me këtë tender. Pra, sqarimet që janë dhënë nga AK kanë krijuar obligime shtesë për palët e interesuara. Ato janë shndërruar në kritere shtesë, të cilat nuk kanë qenë fillimisht pjesë e dosjes së tenderit dhe rrjedhimisht është dashur të respektohen nga Komisioni i vlerësimit të tenderëve në mënyrë që të sigurohet trajtimi i barabartë i ofertuesve. Siç u theksua më sipër, një kërkesë e tillë është kërkuar nga AK edhe me Vendimin e OSHP-së të përmendur më lartë, por as Komisioni i rivlerësimit nuk e ka marrë parasysht këtë. Pretendimi është i bazuar”.
- Lidhur me pretendimin e katërt (IV) - “AK është dashur të kërkoj informata nga OE fitues për llojin e materialit ekuivalent me përshkrimin teknik të tij. Nuk mund të pranohet si përgjigje vetëm Ekuivalent – GoTe Tex pa u verifikuar apo testuar nga një laborator i akredituar. Ky pretendim vlerësohet si pjesërisht i bazuar”.
- Lidhur me pretendimin e pestë (V) - “OE ankues nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për të konfirmuar këtë pretendim. Pretendimi është i pabazuar”.
- Lidhur me pretendimin e gjashtë (VI) - “OE ankues ka bërë një supozim por nuk ka ofruar fakte të matshme dhe të mjaftueshme mbi pretendimin e tij. Pretendimi është i pabazuar”.
- Lidhur me pretendimin e shtatë (VII) - “OE ankues ka bërë një supozim por nuk ka ofruar fakte të matshme dhe të mjaftueshme mbi pretendimin e tij. Pretendimi është i pabazuar”.
- Lidhur me pretendimin e tetë (VIII) - “OE ankues ka bërë një supozim por nuk ka ofruar fakte të matshme dhe të mjaftueshme mbi pretendimin e tij. Pretendimi është i pabazuar”.
- Lidhur me pretendimin e nëntë (IX) - “Shtresat e materialit sipas specifikimi teknik janë materiale polimere dhe se OE ankues në foton e dërguar si dëshmi ka theksuar se është material sfungjer gjë të cilën në kërkesën për rishqyrtim AK nuk e ka demantuar për llojin e materialit. Pretendimi është i bazuar”.
- Lidhur me pretendimin e dhjetë (X) - “Në foton e paraqitur nga OE ankues shihen fraktura në lëkurë të çizmes që vërehet lehtë. Megjithatë në mungesë të atesteve nuk mund të konfirmohet plotësisht pretendimi i OE ankues. Për këtë do të ishte e nevojshme të bëhen testime shtesë laboratorike. Pretendimi është pjesërisht i bazuar”.
- Lidhur me pretendimin e njëmbëdhjetë (XI) - “Nga faktet e paraqitura nga OE ankues vërehet lehtë që shtrojat e ofruara janë shtresa të rrafshta. Pretendimi është i bazuar”.

-Gjetjet e Panelit Shqyrtues-

Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe faktin se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit me datë 02.05.2023 OSHP ka marrë edhe vendimin 80-84/2023. Në këtë vendim ndër të ishte konstatuar se A testet për produktin ‘çizme nuk kanë qenë kërkesë e dosjes së tenderit mirëpo të njëjtat gjatë rrjedhjes së aktiviteti ishin kërkuar nga Autoriteti Kontraktues përmes sqarimeve të datës 28.09.2022 që d.t.th. para ofertimit operatorëve ekonomik dhe të njëjtat ishin shndërruar në kriter dhe/ose kërkesa të autoritetit kontraktues përkitazi me produktin dhe/ose cilësitë e tij në kuptim të nenit 53 të LPP dhe RRPP. Si shembull në arsyetimin e vendimit 80-84/2023 janë cituar edhe përgjigjet e autoritetit kontraktues për operatorët ekonomik si në vijim:

- “dëshmitë e kërkuara nga ne si AK duhet të jenë nga **laborator të akredituar**. Se çka duhet të përmbajë testimi është e specifikuar...” “**A testet e kërkuara** duhet të jenë nga laboratorët e akredituar ndërkombëtar sipas EN ISO standardit të kërkuar në tërësi si produkt final”;
- “...në secilin rast **duhet të dëshmohet me A test laboratorik** se çizmet e ofruara janë testuar në tërësi dhe kanë kaluar A testet konform EN ISO 2047: 2021”;
- “...përderisa **certifikata vjen nga laborator i akredituar** dhe **ka validiten** dhe i plotëson kërkesat e dëshmimeve të kualitetit, lejohet”;
- “**secili produkt i cili është certifikuar nga laboratorët e njohura botërore me ISO standarde do të jenë pjesë e vlerësimit**”;
- “A testet ose certifikata e lëshuara **vetëm për inspektim vizual dhe/ose që nuk kanë akreditimin përkatës** nuk do të jenë të pranueshme për vlerësim”.

Paneli Shqyrtues në vendimin paraprak të cituar si më sipër kishte konstatuar po ashtu se rrjedha e procesit të prokurimit nuk ishte bërë në pajtim me nenin 60 paragrafit 2 të LPP ku përcaktohet që “Nëse autoriteti kontraktues ka përcaktuar në dosjen e tenderit se kontrata publike do të jepet operatorit ekonomik që dorëzon tenderin e përgjegjshëm ekonomikisht më të favorshëm, dhënia e kësaj kontrate do të bëhet vetëm në bazë të kriterëve dhe peshës së tyre përkatëse të përcaktuara në dosjen e tenderit në pajtim me paragrafët 2. dhe 3. të nenit 52 të këtij ligji”. Tutje përmes nenit 52 të LPP përcaktohet se “autoriteti kontraktues duhet të specifikojë çdo kriter në mënyrë objektive dhe kuantitative si dhe duhet të shprehë peshën që i është dhënë atyre dhe se vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në DT mund të shfrytëzohen për vlerësim”.

Produkti (çizmet) në rastin konkret kishte determinuar objektivisht këtë proces prokurimi sepse i njëjti kishte të bënte me kriterin kryesor dhe domethënës duke e nënkuptuar faktin se, ky produkt prezantonte: kriterin bazë të prokurimit, peshën kryesore të DT, specifikat, e tjera, të cilat nga shkresat e kësaj lënde, për të cilat sipas Panelit, nuk ishte vërtetuar se OE i rekomanduar i kishte plotësuar. Prandaj nga shpjegimet e dhëna si më sipër dhe në kontekstin e përgjithshëm të administrimit të provave, mund të vërehet se Vendimi i cituar si më lartë i publikuar nga OSHP lidhur me këtë aktivitet të prokurimit (Nr.Protokoll 80-84/2023), nuk ishte respektuar nga AK, e cila në këtë rast sipas gjykimit të pavarur të këtij panelit, nuk kishte vepruar me kujdesin e duhur profesional ngase gjatë procedurës së rivlerësimit në kundërshtim me vendimin e cituar duke mos prezantuar ndonjë provë dhe/ose dëshmi shtesë për palët në procedurë që realisht do të mund të mbështesin arsyetimin ligjor sipas AK i cili ka reflektuar dhe/ose determinuar rezultatin përfundimtar të vendimit të AK të datës 13.06.2023, duke rekomanduar fituesin e njëjtë për këtë aktivitet, me pretendimin se gjoja oferta e OE të rekomanduar ishte në harmoni me kërkesat e AK përkundër vendikmit të OSHP.

Paneli Shqyrtues nuk mbështet arsyetimin e dhënë nga përfaqësuesit e AK në seancën për shqyrtimin kryesor ku thuhet se "...AK ka rezervuar të drejtën nëse ka dyshime eventuale për mos përputhje të mostrave "çizmeve" me specifikimet e kërkuara në DT, mundet që me mjetet financiare të OE fitues të drejtohej laboratorit të akredituar ndërkombëtarisht për verifikim pas nënshkrimit të kontratës...". Kjo për arsye se pikërisht Autoriteti Kontraktues në përgjigjen e dhënë për operatorët ekonomik kishe pohuar "*A testet ose certifikata e lëshuara vetëm për inspektim vizual dhe/ose që nuk kanë akreditimin përkatës nuk do të jenë të pranueshme për vlerësim.*". Kurse në seancën dëgjimore deklaroi si në vijim "...vlerësimin e kemi bërë bazuar në tabelën e ofruar nga AK në dosje të tenderit ku janë çeken rezultatet dhe metoda e testimit, ndërsa si dëshmi kishin marr tabelën e ofruar nga OE..". Duke shtuar me tej se prodhuesit e veshmbathjeve kanë deklaruar se ofertat e tyre lidhur me specifikat e produkteve, mbi të cilat komisioni ishte orientuar dhe po ashtu citatin "... ne si komision nuk kemi ditur se duhet dhe as nuk kemi kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë" Sipas gjykimit të pavarur të panelit vërehet se Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin e ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar vetëm në bazë të dëshmi të ofruara dhe të emëruara si "katalog" në ofertën e të rekomanduarit.

Paneli Shqyrtues thekson po ashtu se në dosjen e tenderit ishte kërkuar edhe "deklaratë për përmbushjen e specifikacionit teknik". Lidhur me këtë duhet sqaruar se OE i rekomanduar nuk e kishte prezantuar në ofertën e tij këtë deklaratë, megjithatë AK kishte kërkuar sqarime nga ofertuesi tani "i rekomanduar" gjatë fazës së rivlerësimit të cilat veprime sipas këtij paneli konsistojnë të bien në kundërshtim me nenin 72 të LPP lidhur me nenin 38 RRPP, duke ju referuar po ashtu edhe interpretimit të KRPP të datës 01.06.2021 cituar "...Kurdo që kërkohet Deklarata për specifikime teknike në FDT të DT, ajo duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e tenderit..." ngase ky aktivitet ishte iniciuar me datën 01.08.2022.

Mbi bazën e të lartcekurave paneli konstaton si në vijim:

OE i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij fare nuk ka prezantuar A-testet por vetëm një "katalog" e cila në përmbajtje ka rezultate të testimit, mirëpo nuk ka ofruar asnjë dëshmi se të njëjtat janë bërë nga një laborator i akredituar.

AK në procedurë të rivlerësimit sipas vendimit të OSHP 80/84-2023, nuk kishte kërkuar/dëshmuar dhe nuk kishte ofruar ndonjë prova/argument bindës për panelin shqyrtues dhe palët në procedurë, se i rekomanduari ka ofertuar në përputhje me të gjitha kërkesat e specifikacionit teknik, për më tepër deklarimi i AK, në seancën për shqyrtim kryesor, se e njëjta rezervon të drejtën që pas nënshkrimit të kontratës mund të verifikoj nëse eventualisht dyshon për produktin e ofruar.." sipas panelit kjo çasje e AK, konsiston direkt në shkelje të nenit 7 të LPP paragrafi 1 cituar "...Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente tutje paragrafi 2. cituar "...Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik . AK gjatë rrjedhjes së kësaj procedure referuar edhe procedurës së rivlerësimit nuk ka respektuar po ashtu edhe nenin 60 të LPP paragrafi 1 cituar".. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët dhe paragrafi 2. Nëse autoriteti kontraktues ka përcaktuar në dosjen e tenderit se kontrata publike do të jepet operatorit ekonomik që dorëzon tenderin e përgjegjshëm ekonomikisht më të favorshëm, dhënia e kësaj kontrate do të bëhet vetëm në bazë të kriterëve dhe peshës së tyre përkatëse të përcaktuar në dosjen e tenderit në pajtim me paragrafët 2. dhe 3. të nenit 52 të këtij ligji..". Paneli vlerëson se një veprim dhe/ose e drejtë e AK e rezervuar nga cilësia e saj si AK në "specifikacionet teknike", ashtu siç ka pohuar më sipër më tepër i referohet ekzekutimit dhe/ose përmbushjes së kontratës në harmoni me detyrimet kontraktuale e në përputhje me DT, asesi në fazën e vlerësimit ngase AK do duhet të veponte me kujdesin e duhur profesional duke bazuar në nenin 1 dhe 59 të LPP.

AK po ashtu nuk ka vepruar sipas Kërkesës së OSHP e cila obligoj që në seancën e shqyrtimit kryesor ti sjellte ato dëshmi/prova dhe argumente të cilat do ta bindin panelin shqyrtues dhe palët në procedurë se

përse vendimi paraprak i OSHP nuk ishte respektuar nga AK. në kuptim të nenit 116 paragrafi 3 cituar: “...Para marrjes së një vendimi përfundimtar mbi një çështje, OSHP mund të kërkojë nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë. Ngjashëm, OSHP ka të drejtë që të kërkojë nga çdo person, ndërmarrje ose autoritet publik që të sigurojë dëshmi që paneli shqyrtues me arsye mendon se kane të bëjnë me çështjen përkatëse...”

I rekomanduari nuk ka prezantuar në ofertën e tij/saj “deklaratën për specifikacione teknike” e cila ishte kërkuar shprehimisht në DT 19.1 (h) “...Deklaratën me shkrim për specifikacionin teknike furnizimet/punët/shërbimet e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të DT..”

Lidhur me kërkesat e vendosura në pikën 19.1 në Dosjen e Tenderit të cilat janë të ndryshme dhe të ndara për specifikacionet teknike konsistojnë si në vijim:

1. OE është i obliguar që të beje plotësimin, nënshkrimin, dhe vulosjen e aneksit 1 specifikimit teknik i detyrueshëm, dhe mos plotësimi i aneksit 1 sipas kërkesave do të eliminojë nga vlerësimi i mëtutjeshme..” të cilën OE i rekomanduar e kishte plotësuar. Kurse po OE ashtu do duhej të plotësonte edhe kërkesën vijues,

2. Deklaratë me shkrim për specifikacionet teknike” mirëpo OE i rekomanduar nuk e kishte plotësuar deklaratën me shkrim, andaj rrjedhimisht paneli shqyrtues sqaron se i rekomanduari mbi bazën e të lartëcekurave e në konsistencë me vendimeve paraprake të OSHP, 392, 485/23-511/23 cilësohet po ashtu i papërgjegjshëm për këtë aktivitet edhe sa i përket kësaj pike.

Kurse lidhur me dy ofertuesit e tjerë Paneli Shqyrtues, ka marrë parasysh faktin se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit me datë 02.05.2023 kishte marrë vendimin 80/23-84/23 duke mbështetur raportin e ekspertëve shqyrtues/teknik. Prandaj edhe në këtë rast, në procedurën e rivlerësimit OBLIGOHET, AK që të merr për bazë të gjeturat nga ky vendim si dhe vendimi paraprak lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Po ashtu duhet theksuar që Paneli Shqyrtues e përkrah dhe e përcjell tutje te Autoriteti Kontraktues rekomandimin e ekspertit shqyrtues si në vijim “Për vlerësimin e drejtë dhe të paanshëm të ofertave të këtij aktiviteti të prokurimit, rekomandohet që AK të dërgoj mostrat e dorëzuara nga OE në një laborator të akredituar, për të verifikuar që nëse ato përmbushin apo/jo kërkesat teknike të DT”.-

-Përfundimi-

Paneli shqyrtues po ashtu në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 lidhur me 59 dhe 60, 72 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafi 3 dhe 33 të Rregullorës së Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesat e Operatorëve Ekonomik duhet të miratohen si pjesërisht të bazuara. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Ministria e Mbrojtjes të datës 23.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ritender - Furnizim me çizme ushtarake për nevojat e FKS-së” me numër të prokurimit 217-22-7705-1-1-1, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në **Rivlerësim**.

Paneli po ashtu mori vendim si në vijim:

Me Vendimin e datës 02.05.2023, OSHP ka kërkuar që AK ta rivlerësoj aktivitetin e prokurimit në kuptim të rrethanave të shpjeguara në këtë vendim (pa nevojë të përsëriten). Në këtë rast, është jokontestuese se AK nuk ka vepruar në harmoni me Vendimin e cituar, i cili në kuptim të legjislacionit nënkupton aktin administrativ të një organi kompetent, me efekte detyrues për të gjitha palët meqë i njëjti buron nga normat kogente të LPP dhe kompetencat e OSHP, nga cilësia e tij si organ i administratës shtetërore në shkallë të dytë. Paneli konsideron (pa ndonjë paragjykim) se, përfillja e Vendimit të cituar do evitonte në kohë efektive çdo dilemë, në relacion me kriteret e paraparë.

Andaj nga ky kënd i vështrimit, Paneli Shqyrtues konsideron se zyrtari përgjegjës i prokurimit në rastin konkret nuk ka dëshmuar se i plotëson kushtet themelore të kualifikimit sipas nenit 23 të LPP. Kjo për arsye me rastin e menaxhimit të aktivitetit përkatës të prokurimit ka dëshmuar mungesë të theksuar të profesionalizmit në fushën e prokurimit publik. Për këtë arsye është vendosur edhe sipas pikës IV të dispozitivit në këtë vendim. Prandaj OSHP do të kërkoj nga KRPP marrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarit përgjegjës të prokurimit bazuar në nenin 25 paragrafi 9 i LPP.

Përfundimisht, Paneli Shqyrtues i OSHP, kërkon nga AK që në procesin e rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit të evitohen shkeljet e cituara si më sipër të vlerësohen sërish ofertat e operatorëve ekonomik në harmoni me nenit 1,7,27, 59,60, 69 dhe 72 të LPP, të sigurojnë që fondet publike do të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në paragrafët përkatës të nenit 1 të LPP si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 lidhur me nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP. të LPP

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 25 paragrafi 9 lidhur me nenin 105 dhe 116 paragrafi 3 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimet të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTERIA E MBROJTJES, MINISTERIA E MBROJTJES**
- **OE - RUNWAY SH.P.K., Solid SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: